



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2019, ora 11.30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Reni i ditës:

Seancë dëgjimore me Ministrinë e Brendshme për shqyrtimin e projektligjit ‘Për buxhetin e vitit 2020’.

Marrin pjese:

Ermonela Felaj, Alban Zeneli, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Paulin Sterkaj, Anduel Xhindi, Luan Duzha, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi, Luan Harusha, Elena Xhina, Eljo Hysko, Myslim Murrizi, Arben Elezi, Ylli Shehu, Lefter Maliqi, Edmond Rrushi, Nimet Musaj dhe Edmond Stojku.

Mungojnë:

Të ftuar:

Julian Hodaj – Zëvendësministër i Brendshëm.

Viktor Hysaj - Drejtor i Financës në Ministrinë e Brendshme.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Faleminderit, kolegë!

Sikurse kishim njoftuar, do të vijojmë me mbledhjen e sotme të orës 11:30 me dëgjesën për buxhetin e vitit 2020, me institucionin e Ministrisë së Brendshme.

Në këtë dëgjesë është thirrur ministri i Brendshëm dhe orari i mbledhjes u përcaktua me konsensus sipas kërkesës së tij, që, edhe sipas detyrimeve që ka Rregullorja e Kuvendit, ta bëjmë prezantimin e buxhetit me një nismë të brendshme.

Rregullorja e Kuvendit ka një kapitull të posaçëm, që i referohet shqyrtimit në parim dhe nën për nën të buxhetit. Neni 80/1 i Rregullores përcakton që prezantimin e buxhetit duhet ta bëjë ministri përkatës. Natyrisht, mund të jenë prezent edhe persona të tjerë, por Rregullorja nuk lë asnjë mundësi për të zhvilluar seancën pa prezencën e ministrit.

Sot kemi prezent në komision zëvendësministrin e Brendshëm, zotin Julian Hodo dhe zotin Viktor Hysaj, drejtor i Financës në Ministrinë e Brendshme.

Myslim Murrizi – Për procedurë, zonja kryetare.

Të nderuar kolegë,

Në respekt të të gjitha institucioneve dhe të zotërinjve që janë prezent, kërkoj që secili titullar i institucioneve duhet të respektojë institucionin e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, institucionin e parlamentit.

E shikoj pa vend të diskutojmë buxhetin me çdo përfaqësues, të autorizuar apo jo nga titullari i institucionit. Nëse këta ministra kanë kaq shumë punë sa nuk vijnë për gjënë më të rëndësishme që drejtojnë dhe që ka ministria e tyre, për buxhetin, atëherë unë besoj se edhe ne nuk kemi pse të rrahim ujin në hava me të gjithë të dërguarit, që secili ministër mendon se mund ta paraqesë në Komisionin Parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Unë propozoj ta shtyjmë mbledhjen, pasi pa qenë prezent ministri i Brendshëm, i cili ka në varësi të tij rreth 15 mijë punonjës policie, punonjës të Gardës së Republikës, Shërbimin e Çështjeve të Brendshme, Komisioni i Sigurisë nuk ka pse të diskutojë buxhetin e shtetit. Kjo është edhe mungesë serioziteti për anëtarët e qeverisë, të cilët, kanë ardhur, siç kanë ardhur, kërkojnë të përçmojnë çdo institucion tjetër dhe mendojnë se karriget e tyre i kanë peshqesh nga Zoti dhe nuk pyesin për asnjë institucion kushtetues, nga të cilat varen formalisht dhe juridikisht.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Hodaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Unë e mirëkuptoj shumë kolegun tim Murrizi dhe kryetaren.

Në fakt, serioziteti e kërkon të jenë prezent ministrat respektivë, por për atë kohë sa në organikën e rreshtimit të qeverisë, zëvendësministri atribuon dhe kryen misionin e ministrit, mendoj të vazhdojë mbledhja, pasi e kemi ndjekur këtë praktikë edhe në Ministrinë e Mbrojtjes. Dje, pardje ne bëmë mbledhje me Ministrinë e Mbrojtjes dhe ndoqëm të njëjtin standard. Në mbledhjen e fundit që diskutohet për buxhetin nuk kemi pse të kthehemi dhe të propozojmë për të anuluar lejen.

Mua më duket nonsens, pasi zëvendësministri, zëvendëskryeministri, çdo zëvendës, vetë fjala “zëvendës” tregon se ka atributet e ministrit. Për rastin konkret, kryetarja e komisionit, si drejtuesja e komisionit, mund të kontaktonte me ministrin për informacion, por nuk ka arsye të shtyhet mbledhja pse nuk është ministri.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

E para, për dijeninë tuaj dhe të kolegëve, unë si kryetare e komisionit kam komunikuar me ministrin e Brendshëm, si me çdo ministër, dhe kjo mbledhje është lënë pikërisht në këtë orë dhe në këtë ditë, sepse e kërkoi ministri i Brendshëm dhe nuk e vendosëm ne.

E dyta, deri në këtë orë, unë personalisht, që ju përfaqësoj ju të gjithëve në këtë komision, nuk kam asnjë njoftim për mosprezencën e ministrit. Për sa i përket mosparaqitjes së ministres së Mbrojtjes, arsyeja është e njohur, pasi ministrja sapo është bërë nënë dhe ishte e pamundur të ishte prezente në këtë periudhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të jemi korrekt me gjërat. Këtu nuk është rasti për të mbrojtur njërin palë apo palën tjetër. Korrektësia kërkon që ne të njoftohemi paraprakisht.

Kemi pasur mbledhjen e fundit në orën 11:30. Kemi mbaruar dhe të gjithë anëtarët e komisionit kanë qëndruar pikërisht për të zhvilluar këtë mbledhje. Unë do t’jua jap fjalën juve, por unë personalisht nuk kam asnjë njoftim.

Zoti Maliqi, nëse mundeni, vetëm për ...

Lefter Maliqi – Faleminderit!

Kam një ndërhyrje të vogël. Meqenëse zoti Qefalia është prezent për herë të tretë në Komisionin e Sigurisë dhe unë për herë të dytë, dua të them se më parë ministrat kanë qenë të pranishëm. Për të kuptuar rëndësinë e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, mendoj se zoti Lleshaj nuk e ka provuar të jetë deputet. Besoj se duhet të jetë deputet herën tjetër, meqenëse

është ministër, do të jetë anëtar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Mundësia e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, sidomos e kësaj strukture, është shumë e madhe. Kemi Gardën e Republikës, kemi Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, të gjitha institucionet e tjera, ndaj është e domosdoshme që ministri i Brendshëm të jetë i pranishëm. Nuk kemi asgjë me zëvendësministrin dhe me të tjerët.

Ermonela Felaj – Zoti Hodaj.

Julian Hodaj – Zonja kryetare, do të them vetëm dy fjalë.

Unë e kuptoj që jeni në të drejtën tuaj të mos e zhvilloni mbledhjen për shkak të mungesës së ministrit, por zotëria pati një impenjim urgjent dhe urgjenca justifikon edhe atë që ju konsideroni mungesë njoftimi.

Gjithsesi, unë jam i autorizuar, në mungesë të ministrit, të diskutoj edhe projektbuxhetin e vitit 2020.

Ermonela Felaj – Zoti Hodaj, ju falënderoj për gatishmërinë tuaj për të qenë prezent, por Rregullorja e Kuvendit e përcakton qartësisht se duhet të jetë ministri!

Mbledhja do të shtyhet nesër në të njëjtën orë, edhe për faktin se ju e shikoni që deputetët nuk janë të gatshëm ta zhvillojnë pa prezencën e ministrit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA